



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 14.07.2022 -VI-020-616
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Lloji i aktit:	Vendim Nr.001/011-99289 për miratimin e Kartës së Qytetit "E Drejta Mbi Qytetin e Prizrenit"	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues/e,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 07.07.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr.001/011-99289 për miratimin e Kartës së Qytetit "E Drejta Mbi Qytetin e Prizrenit", të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendim Nr.001/011-99289 për miratimin e Kartës së Qytetit "E Drejta Mbi Qytetin e Prizrenit", *sepse* i njëjti ka gabime teknike.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2022, ka miratuar Vendimin Nr.001/011-99289 për miratimin e Kartës së Qytetit "E Drejta Mbi Qytetin e Prizrenit".

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka gabime teknike pasi që titulli i vendimit është për miratim të Kartës së Qytetit "E Drejta Mbi Qytetin e Prizrenit", ndërsa brendia e vendimit ka të bëjë me themelimin e komitetit për Kartën e Qytetit, andaj emërtimi i vendimit duhet të harmonizohet me përmbajtjen e vendimit.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Governmen Administration

Za :	Shaqir Totaj, gradonačelnik opštine Prizren Antigona Bytyqi, predsedavajuća Skupštine opštine Prizren	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljeja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 14.7.2022. Br.020-616
Službenik-ca: za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca: za izradu pravne procene:	Leonora Bajrami, službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za reviziju akta opštine Prizren	
Vrsta akta:	Odluka br.001/011-99289 o odobrenju gradske mape "Pravo nad grad Prizren"	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovana predsedavajuća,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 80.2 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o administrativnim oblastima i odgovornosti Kancelarije i ministarstava kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS, je dana 7.7.2022. godine, primilo na ocenjivanje zakonitosti Odluku br.001/011-99289 o odobrenju gradske mape "Pravo nad grad Prizren, usvojena od strane Skupštine opštine Prizren.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), nakon razmatranja zakonitosti navedenog akta zahteva:

REVIZIJU ZAKONITOSTI AKTA

Odluku br. .001/011-99289 o odobrenju gradske mape "Pravo nad grad Prizren, pošto ista ima tehničkih grešaka."

OBRAZLOŽENJE

Skupština opštine Prizren na sednici održanoj dana 30.6.2022. godine, Odluku br. .001/011-99289 o odobrenju gradske mape "Pravo nad grad Prizren".

Odluku koju je donela Skupština opštine Prizren ima tehničke greške pošto je naslov odluke za usvajanje Povelje grada „Pravo na grad Prizren“, dok je sadržaj odluke o osnivanju komisije za Povelju grada, stoga naziv odluke mora biti usklađen sa sadržinom odluke.

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine zahteva da preduzmu konkretne mere kako bi gore navedeni akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema akta za reviziju.

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.